

RREGULLORE SPORTIVE - DIGITAL MOTORSPORT CUP

1.Kushte të përgjithshme

Gara zhvillohet përmes simulatorit dhe në platformën Forza Motorsport 7. Pjesëmarrja do të jetë e hapur pa regjistrim paraprak dhe do të organizohet në tre ditë pranë ambienteve të Fan Zonë, në Sheshin Skënderbej, Tiranë.

Pjesëmarrësit do të firmosin rregulloren dhe njohjen me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sportive të këtij eventit.

- Pjesëmarrësit

Regjistrimi është i hapur dhe nuk nevojitet eksperiencë e mëparshme e komfirmuar apo licencë për pjesëmarrjen në evente sportive. Lejohet të regjistrohen dhe të marrin pjesë vetëm ata persona që paraqesin një dokument dhe vërtetojnë që kanë lindur deri në fund të vitit 2004.

- Makinat

Kjo garë është ekskluzive për makinat e vëna në dispozicion nga platforma Forza Motorsport 7.

Megjithatë, do të aplikohet kufizimi në një model të vetëm të paracaktuar nga organizatori për të gjitha sesionet e garës, në mënyrë që të garantohet një nivel i balancuar performance midis garuesve.

- Formati i garës

Gara do të zhvillohet në dy faza:

o Kualifikueset

Sesionet kualifikuese do të jenë individuale, në të njëjtën pistë me të njëjtin numër xhiros, në mënyrë që të vendosin xhiron më të shpejtë.

Zhvillimi i kualifikueseve:

Ditën e premte, 09.07.2021, ora 19:30-00:00;

Ditën e shtunë, 10.07.2021, ora 19:30-00:00;

Vendi i zhvillimit: Fan Zonë, Sheshi Skënderbej, Tiranë;

Cirkuiti i përdorur: Catalunya;

Numri i xhirove te zhvilluara: 5

- o Sesionet finale

Për sesionet finale do të kualifikohen vetëm 8 (tetë) kohët më të mira të sesioneve kualifikuese.

Finalet do të zhvillohen në dy sesione: Gjysëm finale dhe finale;

Ndarja e pilotëve në gjysëmfinale do të jetë si vijon.

Gjysëmfinale		
Rezultate Kualifikuese	Pozicioni Gjysëmfinale 1	Pozicioni Gjysëmfinale 2
Garues 1	1	
Garues 2		1
Garues 3	2	
Garues 4		2
Garues 5	3	
Garues 6		3
Garues 7	4	
Garues 8		4

Gjysëmfinalët do të zhvillohen me një total prej 8 xhirosh dhe kalojnë më tej për sesionin final dy vendet e para të secilit sesion gjysëmfinal.

Cirkuiti i përdorur: Catalunya;

Radha e nisjes së pilotëve në sesionin final do të jetë si vijon:

Finale	
Rezultate Gjysëmfinale	Radha e nisjes
Vendi #1 GJF1/2	1
Vendi #1 GJF1/2	2
Vendi #2 GJF1/2	3
Vendi #2 GJF1/2	4

Ndarja midis vendeve të para dhe të dyta të gjysëmfinaleve për radhën e nisjes në finale do të bëhet sipas kohëve të arritura në sesionet kualifikuese.

Numri i xhirove: 10;

Cirkuiti i përdorur: Mugello;

- Regjistrimet

Regjistrimet do të bëhen tek Fan Zone (tenda Box Gamers Club), ku të interesuarit duhet te japin kredencialet, kontakte (nr. Telefoni dhe adresë poste elektronike) dhe një kopje të mjetit të identifikimit.

- Çmimet

Për tre fituesit do të paraqiten kupa për vendin e 1, 2 dhe 3. Fituesi i ACA Digital Motorsport Cup do të përfaqësojë ekipin kombëtar të Shqipërisë edhe në Digital Cup të FIA Motorsport Games që zhvillohet në muajin Tetor në Marsejë, Francë.

- Organizimi

Ky trofe organizohet nga Auto Club Albania dhe me mbështetjen e Ask4Entertainment dhe BOX Gamers Club.

Ambienti: Fun Zone.

- Zyrtaret e garës

Për zhvillimin e garës do të caktohet stafi si vijon:

- Drejtori i garës
- Gjyqtarë
- Sekretaria e garës

Të gjithë pjesëmarrësit do të paguajnë një tarifë regjistrimi prej 500 ALL për të marrë pjesë në sesionet kualifikuese.

Sesionet gjysëmfinale dhe finale do të jenë pa tarifë pjesëmarrje.

- **Sanksionet**

Sanksionet mund të aplikohen kur ndodhin aksidente gjatë garës:

- Aksidentet nënkuptojnë çdo incident ose një seri ngjarjesh që përfshijnë një ose më shumë pilotë ose ndonjë veprim nga çdo pilot, i cili raportohet tek Gjyqtarët nga

Drejtori i Garës ose vërehet nga Gjyqtarët dhe më pas hetohen, në të cilat përfshihen rastet:

- Kur një garues përfiton si pasojë e përplasjes me një makinë tjetër;
- Kur një kundërshtar humbet pozicionin në garë për shkak të përplasjes tuaj me një makinë tjetër;
- Kur një kundërshtar është nxjerrë jashtë piste për shkak të përplasjes tuaj me një makinë tjetër;
- Kur një kundërshtar pëson rrokullisje me makinë për shkak të përplasjes tuaj me një makinë tjetër;
- Kur kundërshtari pëson dëmtime mekanike për shkak të përplasjes tuaj me një makinë tjetër;
- Kur një garues mbrohet me më shumë se 2 (dy) korrigjime të trajektorës në pistë;
- Kur i zini rrugën një shoferi tjetër paralel me ju, duke mos lënë një gjerësi hapësire sa të një makine. ('Paralel' do të thotë të paktën 1/3 e makinës suaj mbrapa makinës përpara).
- Duke detyruar kundërshtarin me forcë që të devijojë përpara kthesës, ndërsa nuk jeni paralel me të. ('Paralel' do të thotë të paktën 1/3 e makinës suaj mbrapa makinës përpara).
- Frenimi në një vend që nuk ka nevojë për frenim. Kryerja e provave të frenimit në pistë;
- Kur ktheheni në pistë pasi keni dalë jashtë piste, duke u kthyer në pistë pa prituri që të kalojë makina që keni mbrapa;
- Prerja e kthesave shkurt gjatë kualifikueseve;
- Kur dilni nga penalizimi dhe bllokoni një makinë tjetër duke mos u larguar nga vija kryesore që është në pistë;
- Sjellje të tjera josportive.

- **Organet kontrolluese**

U takon Gjyqtarëve për të vendosur mbi një raport ose një kërkesë nga Drejtori i Garës, nëse një pilot apo disa pilotë të përfshirë në një aksident, do të penalizohen ose jo.

Nëse një aksident është duke u hetuar nga gjyqtarët, do të shfaqet një mesazh që informon të gjitha ekipet se cili pilot është i përfshirë.

Penalizimet do të njoftohen në përfundim të sesioneve, piloti ose pilotët në fjalë nuk mund të largohen nga pista pa miratimin e Gjyqtarëve.

- **Procesi i Penalitetit**

1. Kur një makinë po hetohet për një penalizim, mesazhi "Nën Hetim" do të shfaqet në ekran;

2. Pasi të jetë caktuar një penalizim, detajet e penalizimit do të njoftohen nga Drejtori i Garës;

Për veprimet e mësipërme mund të jepet një ndëshkim ose s'kualifikim deri në 99 sekonda.

Aksidentet që ndodhin afër fundit të një gare mund të çojnë gjithashtu në shtimin e kohës shtesë pas garës ose s'kualifikim pas gjykimit.

Gjyqtarët mund të vendosin ndonjë prej penalizimeve më poshtë për çdo pilot të përfshirë në një aksident:

- a) Një penalizim i ngadalësuar për një kohë të caktuar. Piloti duhet të hyjë në zonën e ngadalësimit të treguar në pistë, të ngadalësojë për të paktën kohën e dhënë dhe pastaj të ribashkohet me të tjerët në garë.
- b) Një penalitet pas gare.
- c) Një vërejtje.
- d) Zbritje e një numri të caktuar të pozicioneve në renditje.
- e) Nisje nga zona e bokseve.
- g) Fshirja e kohëve ose kohës së xhiros së pilotit.

(Nëse ndonjë nga penalizimet e përmendura në pikat b), c), d), f), g) më lart është vendosur, as dënimi dhe as arsyeja e dënimit nuk do të jenë objekt ankimi).

- **Standartet e garimit**

- a) Një garues duhet të marrë pjesë vetëm i pa asistuar nga dikush tjetër;
- b) Garuesit duhet që gjatë të gjithë kohës të respektojnë rregullat e sjelljes në pistë;

- c) Garuesit duhet të jenë brenda në pistë gjatë të gjithë kohës, konsiderohet jashtë piste ai mjet, i cili del me të katër gomat jashtë vijave kufizuese të pistës;

Garuesit që dalin vazhdimisht jashtë vijave të bardha mund të penalizohen me kohë me sekonda deri në shpalljen e pavlefshme të kohës së kualifikueseve, ose të marrin një penalizim me kalimin në zonën e bokseve gjatë garës.

Një mjet që del jashtë piste për çfarëdo lloj arsye, mund të rikthehet, por me kusht që të sigurohet që nuk përbën rrezik dhe të mos përfitohet nga kjo situatë. Në rast përfitimi, me udhëzim të Drejtorit të Garës, garuesit i krijohet mundësia për ta rikthyer pozicionin.

- d) Nuk lejohet më shumë se një korigjim trajektore për t' u mbrojtur gjatë garës;
- e) Manovrat e qëllimshme për të penguar garimin e pjesëmarrësve të tjerë, si, shtyrja e tyre jashtë kufijve të pistës apo çfarëdo lloj ndryshimi tjetër i pazakontë i trajektores, nuk janë të lejuara.
- f) Mjetet më të ngadalta që arrihen dhe bëhen objekt i dublimit, duhet të lirojnë trajektoren që të kalojë mjeti më i shpejtë. Mosrespektimi i këtij rregulli është i dënueshëm me ulje pozicionesh në renditjen finale deri në skualifikim nga gara.

- **Klasifikimi**

Fitues do të shpallet garuesi që e përfundon në kohën më të shpejtë numrin e xhirove të përcaktuara.

U njoha me kushtet e rregullores dhe jam dakord me sa është shënuar më sipër.



Emër, Mbiemër

Firmë